



Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-76259

Dt. 26.07.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR K – PRIZREN, me kërkesën e **Adem Jetishi** nga Prizreni me banim në rrugën “**Rifat Ukimeri**” **nr.28** me numër të kërkesës 04-353/01-76259/14.06.2024 në bazë të nenit 3. pika 1.11 si dhe nenit 5 alineja 1 Pika 1.3 e në kuptim të nenit 14 alineja – 1 pika 1.5 dhe nenit 15 alineja 1 pika 1.1 dhe neni 19 alineja 2 të Ligjit për Ndërtim Numër 04/L-110 si dhe konform dispozitave të dhe neneve 26 paragrafi 1, nenet 27, 44, 46, 47, 48 dhe 86 të Ligjit për Procedurën Pergjithshme Administrative-LPPA-së numër 05/L-031, e lidhur me dispozitat e neni 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. **LEJOHET: Adem Jetishi** me banim në rrugën “**Rifat Ukimeri**” **nr.28** në zhvillimin e punimeve: **Renovimin e kulmit** të objektit me numër **O-71813068-2422-0 ZK Prizren**, e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-07145-43** e identifikuar sipas kopjes së planit e vërtetuar nga ana e këtij shërbimi.

II. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë të punuar nga ana e byros projektuese “**VM ARCHITECTS**” SH.P.K.

III. Gjatë renovimit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi, zgjerimi në gabarit dhe në etazhitet të objektit.

IV. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m


Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: **Adem Jetishi me banim në rrugën “Rifat Ukimeri”nr.28** me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për renovimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për **Renovimin e kulmit të objektit-Shtëpi individuale me nr të objektit O-71813068-2422-0** , e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-07145-43 ZK Prizren**.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI-së në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:


Xhejlane Gjini, inxh. dip. ark.



DREJTORI:


Pranverim Berisha, jur. dip.

